

V E N D I M
Nr.152, datë 5.4.1994

**PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË
PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHITESAVE TË PENSIONEVE**

Në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pension të posaçëm ose shtesë pensioni shtetëror përfiton personi që plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat "a", "b" e "c" të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe ka mbushur moshën burri 60 vjeç dhe grua 55 vjeç ose nën këto moshë, në qoftë se janë të paaftë për punë sipas vendimit të KMCAP-it.

2. Kërkesa ose propozimi për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni bëhet nga i interesuari ose nga ministritë, institucionet qendrore dhe organizatat ose shoqatat vetëm nëpërmjet këshillit të bashkisë ose rrethit të vendbanimit të personit.

3. Kërkesa ose propozimi përmban gjeneralitetet e të interesuarit (emrin, emrin e babait, mbiemrin, datëlindjen, gjininë), informacion të plotë, të saktë e të hollësishëm për veprimtarinë, funksionet dhe meritat e veçanta në fushat e parashikuara në nenin 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Bashkëngjitur kërkesës paraqiten dokumente dhe dëshmi të nënshkruara nga persona konkretë. Për personat që kanë vuajtur nga persekutimi politik në regjimin komunist, paraqitet edhe statusi i ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, lëshuar sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993.

4. Këshillat e bashkive dhe rretheve verifikojnë me kujdes faktet që përmenden në kërkesë ose propozim. Kur bien dakord me të, nëpërmjet një relacioni të argumentuar, ia përcjellin kërkesën ose propozimin Këshillit të Ministrave, duke propozuar edhe masën e pensionit të posaçëm shtetëror ose të shtesës së pensionit. Në qoftë se këshillat e bashkive ose rretheve nuk e gjejnë të drejtë kërkesën ose propozimin, venë në dijeni sipas rastit propozuesin ose të interesuarin.

5. Pensioni i posaçëm shtetëror nuk mund të jetë më i ulët se pensioni bazë dhe as më i lartë se shuma e pensionit maksimal, plus 20 për qind të këtij të fundit.

Kufiri maksimal i shtesës së pensionit do të jetë deri në pensionin bazë të pleqërisë, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 plus këtë shtesë të mos kalojë pensionin maksimal plus 20 për qind shtesë të këtij të fundit.

6. Me kërkesën e të interesuarve dhe me propozim të këshillit të bashkisë ose rrethit përfitojnë pension familjar, familjarët e personit të vdekur që merrte ose i takonte të merrte pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni. Përfitojnë pension familjar vetëm personat që përmenden në nenin 40 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Masa e pensionit dhe shtesa caktohen në kufijtë e pikës 5 të këtij vendimi.

7. Pensioni, masa dhe data e fillimit të pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit caktohen dhe hiqen me vendim individual të Këshillit të Ministrave.

8. Pensioni i posaçëm shtetëror dhe shtesa e pensionit indeksohen sa herë dhe në masën që indeksohen pensionet e pleqërisë dhe pensionet familjare të përfituara nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

9. Administrimi i pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve bëhet nga instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Shpenzimet për administrimin dhe pagesën e këtyre pensioneve mbulohen nga buxheti i shtetit.

10. Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.1, datë 3.3.1970 "Për dhënien e pensioneve për merita të veçanta" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 tetor 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi